



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 28, datë 09. 10. 2012

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK, NR. 20, DATË 30.04.2007
“PËR KALIMIN E DISA KOMPETENCAVE NJËSIVE BASHKIAKE DHE NJË
NDRYSHIM NË NUMRIN E PUNONJËSVE TË NJËSIVE BASHKIAKE DHE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME NR. 1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 dhe nenit 32, shkronjat “ç” dhe “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, (i ndryshuar); nenit 4 dhe nenit 8, shkronja “m” e ligjit nr. 8654, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”; nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.25, datë 28.12.2012 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2012” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak, nr. 20, datë 30.04.2007 “Për kalimin e disa kompetencave njësive bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të njësive bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit”, si më poshtë:
- Në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e vendimit të mësipërm Kopshti Nr. 22 të hiqet nga lista e emërtesës së shkollave dhe kopshteve nën juridiksionin e Njesisë Bashkiake Nr. 4 dhe të shtohet në listën e emërtesës së shkollave dhe kopshteve nën juridiksionin e Njesisë Bashkiake Nr. 3.
2. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, të reflektojë efektet financiare të ndryshimeve sipas pikës 1 të këtij vendimi, me shtesat dhe pakësimet përkatëse, në buxhetin e vitit 2012 të Njësive Bashkiake Nr. 3 dhe Nr. 4.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Njësia Bashkiake Nr. 3 dhe Nr. 4 për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI